

NË KËTË NUMËR

ZHVILLOHET ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHSSH-së

KRIJOHEN KOMITETET TEKNIKE TË SHSSH-së

FILLOI DISKUTIMI PËR PROJEKT-LIGJIN "PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT".

PREZANTOHET PROJEKTI PËR FUTJEN E SIGURIMEVE NË BUJQËSI.

NËNSHKRUHEN MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT ME SHOQATËN E BANKAVE DHE ATË TË MIKROFINANCËS.

TAKIM ME MINISTREN E SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES.

ZHVILLOHEN KURSET E TRAJNIMIT PËR SHITËS TË PRODUKTEVE TË SIGURIMIT TË JO-JETËS.

SHOQATA E SIGURUESVE TË SHQIPËRISË

Rr. "Ibrahim Rugova",
Pall 21/4, Kati i dytë
Tiranë

Email: info@shoqatasiguruesve.al
www.shoqatasiguruesve.al



Rreth nesh

Historik i shkurtër

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë është themeluar më 29 Janar 2003, me anëtarë themelues të saj 5 shoqëri sigurimi: INSIG SHA, SIGMA SHA, SIGAL SHA, ATLANTIK SHA dhe INTERSIG SHA. Shoqata është regjistruar si person juridik (shoqatë) me vendimin nr. 560, datë 03.03.2003. Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë është shoqatë jo-fitimprurëse dhe përqipet të promovojë standardet më të fundit sigurative të anëtarëve të saj për zhvillimin, stabilitetin dhe efektivitetin e industrisë shqiptare të sigurimeve. Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (SH S SH) është organi përfaqësues i tregut të sigurimeve në marrëdhëniet me të tretë, brënda dhe jashtë Shqipërisë.

Shoqata zgjedh Kryetarin e Shoqatës, i cili drejton punimet e Asamblesë së Përgjithëshme, si dhe emëron Sekretarin e Përgjithshëm të Shoqatës, i cili drejton dhe organizon veprimtarinë e përditshme të Shoqatës.

Që nga krijimi i saj e deri më sot, Kryetar të shoqatës kanë qenë:

Z. Dritan Celaj , në periudhën Mars 2003 – Korrik 2007

Z. Avni Ponari, në periudhën Janar 2008 - Nëntor 2011

Zj. Fitnete Sulaj duke filluar nga Nëntori 2011 e në vazhdim.

ZHVILLOHET ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHSSH-së

Më datën 11 Dhjetor 2017, zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithëshme e Anëtarëve të Shoqatës, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të Shoqatës, ku pas diskutimit të çështjeve të parashikuara në rendin e ditës, të gjithë anëtarët vendosën njëzëri të miratojnë Raportin e Shoqatës për veprimtarinë e saj gjatë vitit 2017 dhe veprimtaritë e parashikuara për vitin 2018, Pasqyrat Financiare për periudhën 11-mujore dhe të pritshmet për vitin 2017, Buxhetin e Shoqatës për vitin 2018 si edhe ndryshimin e logos së Shoqatës.

Në zbatim të nenit 9.1 të Statutit të Shoqatës, Asambleja e Përgjithëshme me unanimitet të plotë rizgjodhi zj.Fitnete Sulaj në postin e Kryetares së Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë për një mandat 1-vjeçar.

KRIJOHEN KOMITETET TEKNIKE TË SHSSH-së

Në vijim të punës për riorganizimin e Shoqatës, në datën 18 Dhjetor 2017 u zhvilluan takimet e Komiteteve Teknike të Shoqatës. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha shoqërive anëtare, sipas grupimeve përkatëse dhe në fund të takimeve u konkludua me krijimin e 3 Komiteteve Teknike, si më poshtë:

Komiteti për zhvillimin e tregut me Kryetare zj. Etleva Dulja

Komiteti ligjor me Kryetar z. Abdyl Sarja

Komiteti për marrëdhënien me publikun me Kryetare zj. Dorinela Ndrejaj

FILLOI DISKUTIMI PËR PROJEKT-LIGJIN "PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT".

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka përgatitur dhe dërguar për diskutim tek Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë projekt-ligjin "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit".

Tregu i sigurimeve, nëpërmjet grupit të punës me specialistët më të mirë të fushës, ka filluar diskutimin dhe debatimin e këtij projekt-ligji me synim realizimin e variantit më të mirë të mundshëm për të gjitha palët e interesuara.

PREZANTOHET PROJEKTI PËR FUTJEN E SIGURIMEVE NË BUJQËSI.

Në kuadër të zgjerimit të gamës së shërbimeve, shoqëritë e sigurimit të jo-jetës, po studiojnë mundësinë e futjes së sigurimeve në sektorin bujqësor, çka përbën edhe një hap të guximshëm dhe historik, në ambjentin ekonomik të vendit.

Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, në bashkëpunim edhe me ekspertë të fushës, ka përgatitur një studim mbi mënyrën se si mund të fillohet ky proces në vendin tonë, sigurisht me mbështetjen e pa diskutueshme të buxhetit të shtetit.

Propozimi i është paraqitur së fundmi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të bashkërenduar kontributet në implementimin e këtij projekti.

NËNSHKRUHEN MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT ME SHOQATËN E BANKAVE DHE ATË TË MIKROFINANCËS.



Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (SHSSH), dhe Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve (SH.S.J.P.F.I), nënshkruan më datë 13 shtator 2017 Memorandumin e Bashkëpunimit. Në ceremoninë e organizuar morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, drejtorë të përgjithshëm të bankave dhe shoqërive të sigurimit, si dhe ekspertë të sektorit financiar.

Po kështu, më 17 Nëntor 2017 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë (SH.S.SH), Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve (SH.S.J.P.F.I) dhe Shoqatës së Mikrofinancës Shqiptare.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë përfaqësues dhe drejtues të lartë të shoqërive të sigurimeve dhe të



mikrofinancës, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ekspertë të tregut financiar, etj.

Përfaqësuesit e shoqatave, u shprehën se palët priren nga sinergji pozitive që së bashku t'i bëjmë gjërat edhe më mirë. Nëpërmjet bashkëpunimit të hapur dhe transparent, nëpërmjet formave të ndryshme të diskutimit në tryeza të rumbullakëta, seminare, forume apo konferenca, nëpërmjet përgatitjes së projekteve, propozimeve apo problematikave, nëpërmjet trajnimeve profesionale për bashkëveprimin e produkteve dhe shërbimeve financiare bankare dhe atyre të sigurimit të jetës dhe jo-jetës, shkëmbimit të informacionit dhe publikimeve të përbashkëta, palët synojnë të sjellin risi në treg në emër të zhvillimit të sektorit bankar dhe atij të mikrofinancës në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë.

TAKIM ME MINISTREN E SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES.

Më datën 26 Janar 2018, një grup i drejtuesve të lartë të tregut të sigurimeve, zhvilloi një takim pune me Ministren e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zj. Sonila Qato.

Drejtuesit e tregut të sigurimeve i paraqitën zj. Qato shqetësimet e deritanishme me të cilat po përballet ky treg, duke kërkuar edhe mbështetjen e saj për kapërcimin e tyre.

Nga ana e saj, zj. Qato, duke vlerësuar kontributin dhe rolin e tregut të sigurimeve në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, i garantoj drejtuesit për mbështetjen e vazhdueshme të saj dhe të institucionit që ajo drejton.

ZHVILLOHEN KURSET E TRAJNIMIT PËR SHITËS TË PRODUKTEVE TË SIGURIMIT TË JO-JETËS.

Gjatë periudhës Shtator 2017– Janar 2018 janë zhvilluar 9 kurse trajnimi për shitës të produkteve të sigurimit të jo-jetës. Këto kurse janë zhvilluar në qytetet e Tiranës, Pogradecit, Fierit, Lezhës dhe Gjirokastrës dhe në to kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar mbi 160 punonjës dhe agentë të shoqërive të sigurimeve.

Temat kryesore të trajtuara në këto kurse kanë qenë: Sigurimi i pronës dhe përgjegjësisë, Sigurimet e mjeteve motorrike, Roli i AMF-së në licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjentit në sigurime, etj.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit janë pajisur me Çertifikatat përkatëse.



ANËTARËT E SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË

